

# Felice Beato dhe/and Adolfo Farsari

Dy Italianë në Lindjen e Largët  
Two Italians in the Far East (1863-1890)



Kuruar nga / Curated by  
Fondazione Alinari per la Fotografia

Konsulente shkencëtare / Scientific consultant  
Rossella Manegazzo

05.04.-07.07.2024

# Felice Beato dhe/and Adolfo Farsari

Dy Italianë në Lindjen e Largët  
Two Italians in the Far East

1863–1890

Felice Beato dhe Adolfo Farsari  
Dy Italianë në Lindjen e Largët  
1863-1890

Në shekullin e udhëtimeve dhe udhëtarëve, fotografia bëhet menjëherë një 'aleate e fuqishme' në përhapjen e njohurive rreth vendeve dhe kulturave ekzotike.

Dy italianë, Felice Beato dhe Adolfo Farsari, japin një kontribut të rëndësishëm në njohjen e Japonisë - e cila vetëm prej vitit 1854 kishte thyer izolimin dy shekullor nga pjesa tjetër e botës - duke nxitur në këtë mënyrë fenomenin kulturor të *Japonizimit* në Evropë. Felice Beato mbërrin në Yokohama në 1863, me një përvojë pioniere si fotograf lufte në Krime, Indi dhe Kinë. Energjik për nga natyra, i pajisur me pasaportë britanike dhe me një rrjet njohjesh diplomatike të rëndësishme, arrin të udhëtojë e të fotografojë në Japoni, vende e situata të paaksesueshme nga të tjerë. Atij i atribuohen arritje të një origjinaliteti të pashoq si zhvillimi i ngjyrosjes me dorë të stampave fotografike në albuminë (me artistë vendas e modele ikonografike ndonjëherë të frymëzuara nga tradita e gdhendjes në dru të Botës Lundruese - *ukiyo*), futja për herë të parë në Japoni e portretit në studio për të rikrijuar traditat dhe zakonet e jetës së përditshme e duke filluar nga viti 1868, tregtimi i albumeve fotografike si suvenirë për udhëtarët perëndimorë. Falë kësaj pune nis edhe lulëzimi i jashtëzakonshëm fotografik i *Yokohama Shashin* (fotografia në stilin e Yokohama-s) përmes formimit në studion e tij të fotografëve si Kusakabe Kimbei, ose edhe përmes arkivit që posedonte. Në vitin 1877 Beato ia shet

aktivitetin mikut të tij, rival në këtë fushë, Raimund von Stillfried. Kjo trashëgimi u koleksionua dhe u përsos në teknikën e ngjyrosjes me dorë nga një tjetër italian, Adolfo Farsari, një aventurier i mbërritur në Japoni më 1863 me pasaportë amerikane (të përfituar mbas pjesëmarrjes në Luftën Civile) i cili me blerjen e arkivit *Stillfried and Anderson*, trashëgoi një pjesë të negativëve në xham të Beato-s.

Këto ngjarje të jashtëzakonshme na tregohen përmes riprodhimit të fletëve të dy albumeve suvenirë me titull *Japan*. Ky lloj produkti ishte i përgatitur enkas për tregun perëndimor, me përshkrime të gjata të daktilografuara në gjuhën angleze e të redaktuara në përshtatje me pikëpamjen perëndimore, përfshirë këtu edhe interpretime që përcjellin paragjykimet e kohës apo që synojnë të vënë në pah, aspektet ekzotike të kulturës japoneze. Albumi *Japan* i Beato-s, i tregtuar nga vetë fotografi si 'Half Album' (Gjysëm Album) përmban 51 fotografi kurse ai i Farsari-t përmban 42 të tilla. Këto vepra të rëndësishme për nga cilësia fotografike, në rastin e Farsari-t në rastin e Farsari-t na përcillen me një kopertinë të çmueshme në llak të zi, me zburime me relief në fildish e llak ngjyrë ari. Të dy albumet janë fryt i punës së një grupi mjeshtërish të zanateve të ndryshme. Në vitin 1891, *A. Farsari and Co.* punësonte 31 shegertë, mes tyre fotografë, asistentë, piktorë e lucidues.

Na shfaqet një Japoni e mvëshur me ëndrra e nostalgji, në rastin e Beato-s kjo edhe për shkak të hijezimeve të ovalet ku ngërthehen subjektet e fotografuar në studio: shembuj të një bukurie të rafinuar femërore, samurai, murgj e skena të jetës së përditshme. Nëse albumi i Beato-s na shoqëron mes traditave dhe zakoneve japoneze, ai i Farsari-t paraqet pamjet e vendeve ikonike që shndrisin në bukurinë e shumëllojshmërinë e ngjyrave të peizazhit të ravijëzuar nga iriset, lule vilet, çelja e qershive, portat e shenjta, tempujt e gdhendur në peizazhe natyrore të magjishme.

Vende të skalitura në kohë e në histori, të paraqitura në imazhe që përpiqen të frenojnë forcën e pashmangshme e shndërruese të modernitetit.



In the century of travel and travelers, photography immediately becomes a powerful ally in disseminating knowledge of exotic lands and cultures. Two Italians, Felice Beato and Adolfo Farsari, made a significant contribution to the understanding of Japan – which, starting from 1854, began to break its two-century-long complete isolation from the rest of the world – contributing to nourish the cultural phenomenon of Japonisme in Europe. Felice Beato arrives in Yokohama in 1863, after a pioneering experience as a war photographer in Crimea, India and China. He has a fiery temperament, a British passport and a significant network of diplomatic connections that allows him to reach and photograph places and situations in Japan that are inaccessible to most. He is credited with some remarkable and groundbreaking achievements: the development of hand colouring of albumen photographic prints (through local artists and iconographic models at times inspired by the woodblock tradition of the Floating World – *ukiyo-e*); the introduction of studio portraiture in Japan to depict customs and traditions of daily life; the crafting, from 1868, of souvenir albums, a product tailored for Western customers. His work marks the onset of the extraordinary blossoming of *Yokohama Shashin* (Yokohama-style Photography), facilitated through the mentorship in his studio, of photographers such as Kusakabe Kimbei, or through the images in his archive, as in the case of his competitor and friend Raimund von Stillfried, to whom Beato handed over the business in

1877. A legacy embraced and taken to the highest levels in hand coloring by another Italian, Adolfo Farsari: an adventurer who arrived in Japan in 1876 with an American passport (obtained after participating in the Civil War). Through the acquisition of the *Stillfried and Anderson* archives, he inherited some of Felice Beato's plates.

These extraordinary events are narrated in the exhibition through the reproduction of the plates from two souvenir albums, both entitled *Japan*. This type of product is clearly intended for the Western market: Beato's album features lengthy typewritten captions in English, written from a Western perspective, not devoid of interpretations reflecting prejudices of the time, or aiming to emphasize the exotic aspects of Japanese culture. Beato's *Japan Album* falls into the type he marketed as 'Half Album' with 51 photographs, while there are 42 subjects in Farsari's Album. Both are significant works in terms of photographic quality. Farsari's album is accompanied by a prestigious cover in typical black lacquer with relief inlays in ivory and gold lacquer. These albums are the result of the work of a team with various specialisations. In 1891, A. Farsari and Co. employed as many as 31 people, including photographers, assistants, painters and lacquerers.

What stands out in these images is a *Japan* wrapped in dreams and nostalgia. In Beato's case, this is particularly evident through the softly shaded ovals enclosing subjects captured in the

studio: examples of refined feminine beauty, samurai, monks and scenes of daily life. While Beato's album guides us through Japanese customs and traditions, in Farsari's work, views of iconic places radiate beauty and chromatic varieties of landscapes adorned with irises, wisterias and cherry blossoms, sacred gates and temples nestled in magical natural settings. Places that seem frozen in time, captured in shots that attempt to retain the inevitable transformative force of modernity.



Felice (Felix) Beato  
(Venezia 1832 – Firenze, 29 janar 1909)

Aventurier, udhëtar e pionier në fotografi, përtej dokumentimit të ngjarjeve të luftës, është ndër perëndimorët e parë që mbërrin në Japoni në fund të periudhës Edo, atëherë kur hyrja e të huajve në vend ishte tejmase e kufizuar për shkak të shogunatit.

Lindi në Venecia dhe u rrit në ishullin e Korfuzit (asokohe protektorat britanik). Mbasi merr nënshtetësinë angleze, e ndërton emrin në Felix. Më 1844, familja transferohet në Kostandinopojë, aty ku lind edhe interesi i tij për fotografinë, falë bashkëpunimit me James Robinson-in, fotograf dhe gdhendës skocez (njëkohësisht drejtues i Mint-it Imperial).

Mes viteve 1853 dhe 1854, Robertson-i hap ndër studiot e para fotografike komerciale në Pera, në lagjen më perëndimore të kryeqytetit, për të cilën Beato realizon disa pamje arkitektonike të Maltës dhe Kostandinopojës. Imazhet e realizuara nga Robertson-i dhe vëllezërit Felice e Antonio Beato, i gjejmë të nënshkruara si “Robertson, Beato & Co”.

Në vitin 1855, Robertson-it i ngarkohet detyra e Roger Fenton-it, i kthyer në atdhe mbas një sëmundjeje, për dokumentimin e Ekspeditës Britanike në Luftën e Krimesë. Robertson-i dërgon aty Beato-n, i cili mes prillit dhe korrikut 1856, fotografon konfliktin dhe pasojat e tij. Është lufta e parë e

dokumentuar përmes fotografisë dhe kjo bën jehonë në shtypin e kohës.

Në fillim të viteve 1857, vëllezërit Beato nisen bashkë me Robertson-in, drejt Lindjes së Mesme: në Tokën e Shenjtë, në Egjipt e në Greqi. Në janar 1858, emrat e Robertson-it dhe Beato-s na shfaqen bashkë në një ekspozitë fotografike të Architectural Photographic Association në Londër. Në muajt që pasojnë, dy fotografët nisen drejt kufinjve të shtrirjes së Perandorisë Britanike e cila gradualisht, po u hapet perëndimoreve. Ndalojnë në Indi, ku dokumentojnë shtypjen angleze të revoltave civile.

Më 26 shkurt 1860, Beato niset drejt Kinës nën shoqërinë e Sir James Hope Grant, komandant britanik në fushatën finale të Luftës së Dytë të Opiumit e në mars mbërrin në Hong Kong. Fotografon Hong Kongun dhe Kantonin. Në maj ndodhet në Kinën perëndimore së bashku me Charles Wirgman-in, ilustrues e korrespondent i “Illustrated London News”. Të dy shoqërojnë ekspeditën ushtarake të Aleatëve në Veri, e cila me 13 tetor, hyn në Pekin. Beato fotografon Pallatin Mbretëror Veror dhe skena luftime. Në dhjetor, Beato dhe Wirgman-i kthehen në Hong Kong.

Në qershor 1863, Wirgman-i vendoset në Yokohama ku Beato i bashkohet pak më vonë. Në vitin 1864 ata themelojnë “Beato & Wirgman, Artists and Photographers” e cila do të qëndrojë e hapur deri më 1867. Në tetorin e vitit

1866, ndonëse një zjarr shkatërron dy të tretat e qytetit të Yokohama-s, përfshirë këtu edhe studion dhe një pjesë të madhe të materialit, Beato e vijon aktivitetin e tij. Mes asistentëve gjejmë edhe Kusakabe Kimbei. Në vitin 1870, studioja merr emrin “F. Beato & Co., Photographers with Felix Beato and J. Goddard (absent)” dhe një vit më vonë njihet si “Beato & Co., F, photographers no 17, Felix Beato, J. Goddard, Woollett.” Beato realizon stampime në albuminë nga lastrat e xhamit me kolodium të lëngshëm të cilat kërkojnë kohë të gjatë ekspozimi ndaj edhe një përkujdesje të posaçme ndaj pozimit. Ndërhyn pastaj mbi to duke i ngjyrosur me pigmente të traditës japoneze për të cilat nevojiten orë të gjata pune nga ana e artistëve vendas që bashkëpunojnë me atelieron.

Në vitin 1871 shkon në Kore si fotograf zyrtar në ekspeditën e marinës amerikane, e më pas në Shangai. Asokohe në studio punojnë John Goddard, asistenti H. Woollett, katër fotografë japonezë dhe katër artistë japonezë. Më 6 gusht 1873 emërohet konsull i përgjithshëm i Greqisë në Japoni. Përtej aktivitetit si fotograf e tregtar, Beato është një personazh i njohur edhe për personalitetin e tij, aq sa shfaqet edhe në karikatura e vinjeta humoristike të revistës “Japan Punch”.

Studioja e njohur në vitin 1876 si “F. Beato & Co., Photographers, Felice Beato with H. Woollett, assistant,” më 1877 ia shet aktivitetin rivalëve të saj, baronit Raimund von Stillfried

dhe Hermann Andersen-it të “Japan Photographic Association.” Beato vetë vazhdon të jetojë në Japoni ku vijon aktivitetin e tij tregtar e financiar e rezulton i përfshirë në shumë çështje gjyqësore. Largohet përfundimisht nga Japonia në vitin 1884 dhe mbërrin në Egjipt. Shkon në Sudan një vit më vonë e ndërkohë në Japoni firma “Stillfried & Anderson” mbyll aktivitetin e saj. “Farsari & Company” blen nga Stillfried-i pjesën më të madhe të negativëve të Beato-s (disa negativë blihen nga Kusakabe Kimbei, asistent i tij, i cili tashmë ishte bërë një fotograf shumë i rëndësishëm). Beato kthehet në Londër në shtator 1885. Në vitin 1886, një zjarr shkatërron studion e Farsari-t në Yokohama e me të, edhe negativët e Beato-s.

Në vitin 1888 kthehet në Azi. Në 1894 në Mandalay të Birmanisë hap me dy asistentët e tij “Photographic studio, etc.,” që është njëkohësisht edhe “curio-dealer” (dyqan suveniresh), me filial në Rangoon të cilin e shet më 1898. Më 1907 transferohet në Firenze ku edhe ndahet nga jeta më 1909. Prehet në varrezat e San Miniato al Monte.

Adolfo Farsari (Vicenza, 2 shkurt 1841 – Vicenza 7 shkurt 1898)

Adolfo koleksionon trashëgiminë e Beato-s. Rrjedh nga një familje e kamur borgjeze e mbasi ndjek Akademinë Ushtarake në Modena, bëhet pjesë e Regjimentit V të Brigadës së Granatierëve të Napolit, deri në vitin 1863, kur nisat drejt Nju Jorkut me anijen austriake *Aquila*.

Pak muaj pas mbërritjes në Amerikë, martohet me Mary Patchen-in dhe me 9 dhjetor nisat në rradhët e Nordistëve në Luftën Civile, duke u bërë pjesë e Regjimentit të Kavalerisë së Nju Jorkut. Në një letër të 28 korrikut 1864, tregon: “Në regjiment më thërrasin Garibaldi e askush nuk më njeh me emër tjetër përveç këtij, mbasi jam italian i vetëm i këtij regjimenti.” I plagosur dy herë, lirohet nga detyra më 19 korrik 1865. Një vit më vonë Farsari, i cili tashmë ka marrë nënshtetësinë amerikane, merret me ngarkimin e anijeve tregtare në Brooklyn. Nga këtu, kalon pesë vitet në vazhdim duke bërë xhiron e botës. Më 1876 nisat nga San Francisco me anijen *Belgic* dhe mbërrin në Yokohama. Janë vitet e epokës Meji në të cilat vendi, i izoluar prej shekujsh, i hapet botës perëndimore e njeh një bum turistik e tregtar të jashtëzakonshëm.

Më 1878, *The Japan Directory*, lista e kompanive tregtare në Yokohama, e citon Farsari-n si menaxher të “Yokohama Cigar Company”, një sipërmarrje cigaresh. Më 1879, firma “Sargent Farsari

& Co.” e cila shet artikuj të ndryshëm mes të cilëve harta, libra e revista importi, digjet nga zjarri. Në përfundim të bashkëpunimit me Sargent-in në vitet 1883 dhe 1884, Farsari hap firmën “A. Farsari & Co.” së bashku me Kozaburo Tamamura, i cili në vitin 1885 i blen Franz von Stillfried-it (vëllait di Raimund von Stillfried-it) studion dhe repertorin e negativëve të “Japan Photographic Association”. Mëson profesionin e fotografit si autodidakt. Një vit më vonë humb një çështje gjyqësore ndaj ortakut Tamamura e një zjarr i shkaktërron studion dhe negativët e blerë nga Stillfried-i.

Në një letër të janarit 1888 shkruan: “Tani jam artist, fotograf, piktor etj. etj. Tregtia për momentin që flasim, po ecën shumë mirë. Nëse zjarri (i dyti) i shkurtit 1886 nuk do të më kishte shkaktuar dëme prej 6000 dollarësh e nuk do të më kishte detyruar të filloj nga zero, jam i sigurt që do të isha tërhequr nga tregtia mbas një viti. (...) E kam hapur studion 12 muaj më parë e punët po më shkojnë për mrekulli. Suksesi im i detyrohet mënyrës së pikturimit e cila nuk mund të imitohet as këtu, as në Evropë e as në Amerikë.”

Në shkurt të vitit 1889 i shkruan së motrës: “Siç mund ta shikosh nga kjo fletë e Drejtorisë së Japonisë që po ia bashkangjis kësaj letre, kam shumë të punësuar, 31 syresh, ndër ta artistë, stampues etj. etj. e biles edhe dy kamarierë e një kuzhinier.” Fotografitë e tij çmohen për një kompozim të kujdesshëm të imazhit, për cilësi të

lartë të letrës e të ngjyrave si dhe për mjeshtërinë e rrallë artizanale në ngjyrosje.

Në tentativën e dështuar për të rimarrë nënshtetësinë italiane, e cila i ishte mohuar për shkak të pjesëmarrjes në luftë me ushtrinë e një shteti tjetër, i dhuron mbretit Umberto I, njërin prej albumeve të tij me fotografi. Në vitin 1889 merr medaljen e bronzit në Ekspozitën Fotografike të Berlinit e një vit më vonë, i dorëzohet titulli i nderit, Kavalier i Urdhërit të Kurorës së Italisë. Në bordin e avullores *Congo*, më 6 prill 1890 largohet përfundimisht nga Yokohama e vjen në Itali bashkë me të bijën, Kiku. Në Itali organizon spektaklin “Aventurat e Kav. Adolfo Farsari në Japoni”. Ndahet nga jeta më 7 shkurt 1898. Prehet në varrezën komunale të Vicenza-s.

## FOTOGRAFIA E YOKOHAMA-S

Imazhet e këtij seksioni, të digjitalizuara e të riprodhuara për herë të parë për këtë ekspozitë, i përkasin Kusakabe Kimbei-t (asistent i Beato-s e fotograf me rëndësi) dhe Stillfried-it, pronar i studios rivale i cili në vitin 1885 ia shet negativët e Beato-s, studios së Farsari-t e një pjesë edhe Kimbei-t.

Ishte praktikë e zakonshme, mes fotografëve komercialë, rishitja e fotografive të blera nga të tjerë, nën emrin e tyre. Pas blerjes së negativëve të Beato-s, Stillfried-i e Kimbei shtojnë edhe emrat e nënshkrimet e tyre mbi

vetë negativët, printimet apo kornizat. Po ashtu, riprodhojnë edhe kopjet e ngjyrosura me dorë të stampimeve të Beato-s ndaj dhe përcaktimi i autorësisë bëhet i vështirë dhe i paqartë.

Nën gjurmët e Beato-s dhe Farsari-t, shumë fotografë ndërmarrin aktivitete të suksesshme. *Yokohama Shashin* (fotografia në stilin e Yokohama-s) korr shumë sukses falë turizmit në rritje, aq sa albumet i shiten si suvenirë udhëtarëve që zbarkojnë nga anijet në portet e Yokohama-s, Hakodate-s e Nagasaki-t. Jehona e tyre ndikon në hapjen e studiove fotografike në të gjithë vendin, duke përdorur mjeshtërinë e artizanëve dhe artistëve lokalë. Albumet që tregojnë për një vend në zhvillim sa të avashtë aq edhe të pashmangshëm, bëhen ndër produktet kryesore të eksportit për tregun japonez.

Ky aktivitet tregtar, i kthyer tashmë në stil dhe modë, vijon deri në fillimet e Nëntëqindës, falë kontributit të rëndësishëm të dy italianëve të cilët kishin eksportuar me sukses fotografinë jo vetëm në Japoni, por edhe në vende të tjera të botës. Farsari, në shtatorin e vitit 1888, i shkruan prindërve: “Nuk mbaj mend asgjë nga fotografia në Itali. E krahasimisht me atëherë, fotografia sot ka marrë një zhvillim të jashtëzakonshëm. Bëheshin fotografi të mira edhe në Itali asokohe. Fotografët më të mirë në Londër, Nju Jork e në qytete të tjera të rëndësishme, janë italianë.”





Felice (Felix) Beato (Venice 1832 – Florence, 29 January 1909)

Adventurer, traveler and pioneering photographer, Beato documented significant wartime events and was among the first Westerners who travelled to Japan at the end of the Edo period, when access to the country was severely restricted to foreigners by the shogunate.

Born in Venice, he grew up on the island of Corfu (then a British protectorate). A naturalized English citizen, he changed his name to Felix. In 1844 his family moved to Constantinople where he became interested in photography thanks to his collaboration with James Robinson, a Scottish photographer and engraver (as well as the director of the Imperial Mint).

Between 1853 and 1854 Robertson opened one of the first commercial photography studios in Pera, the most European district of the capital, and Beato was the author of several architectural views of Malta and Constantinople. The images, produced by Robertson and the brothers Felice and Antonio Beato were signed “Robertson, Beato & Co.”

In 1855, Robertson followed Roger Fenton, who had returned home due to health problems, in the task of documenting the British Expedition in the Crimean War. Robertson sent Beato to cover the conflict and its aftermath,

from April to July 1856. It was the first war that had a photographic coverage and an echo in the press.

At the beginning of 1857 the Beato brothers, along with Robertson, embarked on an expedition to the Middle East: the Holy Land, Egypt and Greece. In January 1858 the names of Robertson and Beato appeared jointly in a photography exhibition at the Architectural Photographic Association in London. The following month, the two photographers set sail to the frontiers of the British Empire which were gradually opening up to Westerners. They made a stop in India, where they documented the British suppression of civil uprisings.

On February 26, 1860, Beato set sail to China with Sir James Hope Grant, the British Commander in the final campaign of the Second Opium War, and arrived in Hong Kong in March. He photographed Hong Kong and Canton. In May, he was on the Chinese mainland with Charles Wirgman, an illustrator and correspondent for the “Illustrated London News.” The two accompanied the allied military expedition to the North entering Beijing on October 13. Beato photographed the Summer Palace and some scenes of the battle. In December, Beato and Wirgman returned to Hong Kong.

In June 1863 Wirgman moved to Yokohama, where Beato joined him shortly afterward. In 1864 they founded “Beato & Wirgman, Artists and

Photographers” which was active until 1867. In October 1866, despite a devastating fire that destroyed two-thirds of the city of Yokohama, including the studio and much of its material, Beato continued his work. Among his assistants was Kusakabe Kimbei. By 1870 the studio was named “F. Beato & Co., Photographers with Felix Beato and J. Goddard (absent).” The following year it became “Beato & Co., F, photographers no 17, Felix Beato, J. Goddard, Woollett.” Beato produced albumen prints obtained from wet collodion plates, which demanded relatively long exposure times and consequently much care and attention in posing. He also intervened in the studio by coloring the prints with pigments in line with Japanese tradition: this process required many hours of work by the local artists who collaborated with the studio.

In 1871 Beato traveled to Korea as the official photographer of the American naval expedition, and then to Shanghai. At that time the studio staff included John Goddard, assistant H. Woollett, four Japanese photographers and four Japanese artists. On August 6, 1873 he was appointed Consul General of Greece in Japan. Beato was quite well-known as a photographer and as a businessman but also for his personality so much so that he appeared in caricatures and funny sketches in the magazine “Japan Punch.”

In 1876 the studio was known as “F. Beato & Co., Photographers, Felice Beato with H. Woollett, assistant,” and

the following year it was taken over by Baron Raimund von Stillfried and Hermann Andersen of the “Japan Photographic Association,” one of its main competitors. However, Beato remained in Japan where he continued his commercial and financial ventures and became involved in numerous legal cases. He left Japan in 1884 and moved to Egypt. The following year he traveled to Sudan. Meanwhile, in Japan, the firm “Stillfried & Anderson” closed down and “Farsari & Company” acquired most of Beato’s negatives from Stillfried (some negatives were purchased by Kusakabe Kimbei, the former assistant who had become an important photographer by then). Beato returned to London in September 1885. In 1886, a fire destroyed Farsari’s studio in Yokohama, along with Beato’s negatives.

In 1888, Beato travelled back to Asia. In 1894, in Mandalay, Burma, he opened the “Photographic studio, etc.,” which also operated as a “curio-dealer” (a shop selling bizarre objects), with two assistants and a branch in Rangoon which he sold in 1898. In 1907 he moved to Florence where he passed away in 1909. He is buried at the San Miniato al Monte cemetery.

Adolfo Farsari (Vicenza, February 2, 1841 – Vicenza 7, February 1898)

Adolfo inherited Beato's legacy. He came from a wealthy bourgeois family and, after attending the Military Academy of Modena, joined the 5th Regiment of the Grenadiers Brigade of Naples. He stayed with the regiment until 1863, when he boarded the Austrian ship *Aquila* to New York.

A few months after arriving in the States, he married Mary Patchen and on December 9 joined the ranks of the Union army in the Civil War, enlisting in the 12th New York Cavalry Regiment. In a letter dated July 28, 1864, he writes: "In the regiment, I am called Garibaldi and I am only known by this name because I am the only Italian who is part of this regiment." Wounded twice, he is discharged on July 19, 1865.

The following year Farsari, having become an American citizen, works at the cargo of merchant ships in Brooklyn. Later, following his enlistment, he spends five years traveling around the world. In 1876 he sets sail to San Francisco aboard the ship *Belgic* and arrives in Yokohama. These are the years of the Meiji era, when the country, after century long isolation, opens up to the Western world and harbour cities experience an unprecedented touristic and commercial boom.

In 1878 *The Japan Directory*, listing business companies in Yokohama,

mentions Farsari as the manager of the "Yokohama Cigar Company," a cigar firm. In 1879 the firm "Sargent Farsari & Co.," which sold various items including imported maps, books and magazines, is damaged by a fire. Putting an end to his partnership with Sargent between 1883 and 1884, Farsari establishes the firm "A. Farsari & Co." in collaboration with Kozaburo Tamamura who in 1885 had acquired the studio and the inventory of negatives of the "Japan Photographic Association" from Franz Von Stillfried (Raimund Von Stillfried's brother). A self-taught person, he ventured into photography but the following year, Farsari lost a lawsuit he had filed against his partner Tamamura and a fire destroyed the studio and the negatives purchased from Stillfried.

In a letter dated January 1888 he writes: "Now I am an artist, photographer, painter, etc., etc., and business is currently going great. If a fire (the second fire) in February 1886 had not caused me to lose \$6000 and forced me to start from scratch, I am sure I would have retired from business within another year. (...) It has already been 12 months since I opened my studio, and I have already made terrific deals. The reason for my success is that my painting method cannot be imitated either here or in Europe or America."

Later on, in February 1889, he writes to his sister: "As you can see from a page of the Directory of Japan enclosed in this letter, I have a large staff. 31 artists, printmakers, etc., etc., and also two

maids and a cook." His photographs boast careful composition, excellent paper and color quality and a fine artisanal technique in coloring.

In a futile attempt to reacquire the Italian nationality, which he had been denied because he had joined and fought with the army of another nation, he offers King Umberto I one of his photographic albums. In 1889 the Berlin Photographic Exhibition awards him with the bronze medal and the following year he is honored with the title of Knight of the Order of the Crown of Italy. On April 6, 1890, aboard the steamship *Congo*, he departs from Yokohama to Italy with his daughter Kiku. Upon his return, he stages the show "The Adventures of Cav. Adolfo Farsari in Japan." Farsari passed away on February 7, 1898. He is buried at Vicenza municipal cemetery.

## YOKOHAMA PHOTOGRAPHY

The images in this section, digitized and reproduced for the first time during the exhibition, are attributed to Kusakabe Kimbei (who was an assistant to Beato and later a prominent photographer himself) and Stillfried, owner of a competing studio who will sell Beato's negatives to the Farsari studio and partly to Kimbei in 1885.

It was common practice among commercial photographers to resell photographs purchased from others under their own names. Stillfried and

Kimbei, by acquiring Beato's negatives, added names and inscriptions related to their own firm on the negatives themselves, on the prints, or on the mountings. They also produced hand-colored copies of Beato's prints. This is why attributing authorship to these images is often complex and uncertain.

Following in the footsteps of Beato and Farsari, many photographers embarked on successful ventures. *Yokohama Shashin* (Yokohama-style Photography) owes its fortune to growing tourism: albums were sold as souvenirs to travelers disembarking from ships at the ports of Yokohama, Hakodate and Nagasaki. Their success led to a proliferation of photographic studios throughout the country, employing local craftsmen and artists. These albums, depicting a country in slow yet inevitable transformation, became one of the main export products of the Japanese market.

A flourishing business that evolved into a style and a trend and lived on until the early 1900s, thanks to the significant contributions of two Italians. Italians indeed had successfully exported photography not only to Japan but also to other parts of the world. In September 1888 Farsari wrote to his parents: "I don't remember much about the state of photography in Italy. Since then photography has made a lot of progress. However, good photographs were being produced in Italy even at that time. The best photographers in London, New York and many other major cities, are Italian."

FELICE BEATO DHE ADOLFO FARSARI  
DY ITALIANË NË LINDJEN E LARGËT /  
TWO ITALIANS IN THE FAR EAST  
(1863–1890)

05.04.–07.07.2024

Kuruar nga / Curated by  
Fondazione Alinari per la Fotografia

Një ekspozitë nga / An exhibition by  
Muzeu Kombëtar i Fotografisë “Marubi” /  
Marubi National Museum of Photography  
Fondazione Alinari per la Fotografia

Mbështetur nga / Supported by  
Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit /  
Ministry of Economy, Culture and Innovation  
Istituto Italian i Kulturës në Tiranë /  
Istituto Italiano di Cultura di Tirana

Konsulente shkencore /  
Scientific consultant  
Rossella Menegazzo

Koncepti dhe kërkimi ikonografik /  
Concept and Iconographic Research  
Rita Scartoni

Koordinatorë të ekspozitës /  
Exhibition coordinators  
Claudia Baroncini  
Luçjan Bedeni

Tekstet dhe titujt / Texts and Captions  
Rita Scartoni, Muriel Prandato,  
Francesca Romana Raganella

Përkthimi / Translation  
Tereza Çuni

Printimet / Fine Art Prints  
Centerchrome, Calenzano (Firenze)

Instalimi / Set up  
Kolë Guraziu, Gjergj Spathari

Projekti grafik / Design  
Bardhi Haliti

Drejtor / Director  
Dr. Luçjan Bedeni

Përgjegjësi i Sektorit të Financës dhe Shërbimeve  
Mbështetëse / Head of the Finance and Services  
Department  
Andi Hysa

Përgjegjësi i Sektorit të Menaxhimit dhe  
Konservimit të Koleksioneve / Head of the  
Conservation and Management of the Collections  
Noel Mosi

Përgjegjësi i Sektorit të Komunikimit dhe  
Promocionit / Head of the Communication and  
Promotion Department  
Tereza Çuni

Falenderime / Acknowledgements  
Giorgio van Straten – President of Fondazione Alinari  
per la Fotografia  
Alessandro Ruggiera – Drejtor / Director of Istituto  
Italiano di Cultura di Tirana

Punonjësit e muzeut / Museum staff  
Gjergj Spathari  
Kolë Guraziu  
Lek Gjeloşi  
Lindita Selimaj  
Marina Lazri  
Suela Mema  
Antonela Fishta  
Donatela Fishta  
Gent Puka  
Jozefina Vokrri

Punonjësit / Fondazione Alinari per La Fotografia staff  
Francesca Bongioanni  
Serena Brunori  
Elisa Ghelardi  
Giorgia Simioni

MUZEU KOMBËTAR I FOTOGRAFISË “MARUBI”  
Rruga Kolë Idromeno, nr. 32  
Shkodër, Shqipëri  
+355 22 400 500  
info@marubi.gov.al  
www.marubi.gov.al

## ORARI

E martë – E shtunë: 09:00–16:00

E diel: 10:00–15:00

## BILETA

→ Biletë individuale (në sportel)	700 Lekë
→ Biletë individuale (www.myticket.al)	600 Lekë
→ Biletë grupi +12	600 Lekë
→ Jetimët, invalidët, pensionistët	350 Lekë
→ Studentët, fëmijë nga moshë 12–18	210 Lekë
→ Fëmijë nën 12	0 Lekë
→ Veteranë luftime	0 Lekë
→ Ish të dënuar dhe të përndjekur politikë	0 Lekë
→ Invalidë paraplegjikë dhe tetraplegjikë	0 Lekë
→ Studentë dhe nxënës shkollash në kuadër të zhvillimeve të orëve mësimore apo programit “Edukimi përmes kulturës”	0 Lekë
→ Anëtarët ICOMOS – ICOM	0 Lekë
→ Punonjësit e ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe institucioneve në varësi të kësaj ministrie	0 Lekë
→ Delegacionet zyrtare shtetërore	0 Lekë

## HOURS

Tuesday – Saturday: 09:00–16:00

Sunday: 10:00–15:00

## ADMISSION

→ Adults (reception desk)	700 Lekë
→ Adults (www.myticket.al)	600 Lekë
→ Groups over 12	600 Lekë
→ Orphans, people with disabilities, seniors	350 Lekë
→ Students, pupils (ages 12–18)	210 Lekë
→ Children under the age of 12	0 Lekë
→ War veterans	0 Lekë
→ Former political prisoners	0 Lekë
→ Paraplegic and tetraplegic invalids	0 Lekë
→ Albanian students and pupils visiting the museum during lesson hours or the program “Education through culture”	0 Lekë
→ ICOMOS – ICOM members	0 Lekë
→ Staff of the Ministry responsible for cultural heritage and subordinate institutions of the above mentioned Ministry	0 Lekë
→ National delegations	0 Lekë